



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°12/2022

Hagë, 31/03/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në çështjen *Salih Mustafa*, gjatë gjithë kësaj jave janë mbajtur seanca gjyqësore. Deri tani, që prej fillimit të paraqitjes së provave të veta javën e shkuar, Mbrojtja e z. Mustafa ka thirrur katër dëshmitarë për të dëshmuar. Si Mbrojtja dhe Prokuroria, ashtu edhe mbrojtësja e viktimave dhe Trupi Gjykues i kanë drejtuar pyetje disa prej dëshmitarëve. Pjesa më e madhe e dëshmive janë dhënë në seancë publike.

Seancat janë planifikuar të vazhdojnë të hënën, të martën dhe të mërkurën e javës së ardhshme.

Konferenca e radhës për ecurinë në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala* do të mbahet më 14 prill.

Më 25 mars, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë apelet e Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit kundër vendimeve të Gjykatës të Procedurës Paraprake, në të cilat urdhëronte vazhdimin e mbajtjes së tyre në paraburgim.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje.

